

AKTI I THEMELIMIT

PËR SHOQËRINË “EVI-ACENTER” SHPK

FORMIMI I SHOQËRISË

Sot në Tiranë në datën 24 Shkurt 2021 themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar “EVI-ACENTER” shpk, me vullnetin e lirë të ortakëve:

1. Nazif Dinoshi, i biri Bilal, i datëlindjes 08/02/1985 lindur dhe banues ne Tirane ,Rruga "Liqeni i Thate", Pallati nr 2, Ap29, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr personal I50208054L.

Francesco Carbone, i biri Mikeles, i datëlindjes 19/03/1968 lindur dhe banues ne Itali ,Ottaviano (NA), madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr pasaporte YA5067818

SELIA E SHOQËRISË

1. Shoqëria tregëtare "EVI-ACENTER " SHPK., ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në qytetin e **Tiranë, Bulevardi Gjergj Fishta ,Rruga "Marsel Kashem", Pallati 3, Kati 1**, me vendim të ortakëve të shoqërisë, mund të ngrihen edhe filiale, degë apo dhe seli përfaqësimi në vende të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë.

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

1. Shoqëria Tregtare “EVI-ACENTER” SHPK., do të përmbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.
2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshirë edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 10 000 000 lekë (dhjetë milion lekë), i cili është tërësisht kapital financiar. Kapitali themeltar është i ndare në dy kuota me vlerë nominale 6 900 000 lekë (Gjashte milion e nenteqind mije lekë) dhe 3 100 000 (Tre milion e nje qind mije leke)
Kapitali themeltar zotërohet nga:

1. **Nazif Dinoshi**, zotërues i një kuote apo 69 % të kapitalit të shoqërisë me vlere 6 900 000 lekë (Gjashte milion e nenteqind mije lekë).
2. **Francesco Carbone**, zotërues i një kuote apo 31 % të kapitalit të shoqërisë me vlere 3 100 000 (Tre milion e nje qind mije leke).

Kapitali fillestar nuk është paguar.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË:

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “EVI-ACENTER” shpk do të jetë :

Import - Eksport, Call-center ,Marketing dhe shitje ne distance,Tregeti dhe dhenie me qira te automjeteve .Sherbime ndermjetesimi.Te tjera aktivitete te pa permendura qe i lejon ligji.

Me zgjerimin e aktivitetit shoqëria mund të bëjë shtesa të ndryshme ose ndryshime të objektit të veprimtarisë së saj duke bërë ndryshimet përkatëse në statut.

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

1.Organi drejtues i shoqërisë është asambleja e përgjithshme e ortakëve e cila është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështje të mëposhtme :

a- për ndryshime në statut

b-emërimin dhe shkarkimin e administratorit

c-miratimin e bilancit dhe të pasqyrave financiare vjetore.

d- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit

e-riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Administratori i përgjithshëm i shoqërisë , është **Nazif Dinoshi** me afat 5 vjeçar me te drejtë ripërtëritje.

BAZA LIGJORE

E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 date 14.04.2008” Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare “ si dhe në legjislacionin në përgjithësi të Republikës së Shqipërisë.

Ky Akt Themelimi u nënshkrua në tre kopje të barasvlefshme të tij.

Njëri prej tyre ruhet në selinë e shoqërisë.

ORTAKET:

Nazif Dinoshi

Francesco Carbone